



AVOKATI I POPULLIT

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Administratës

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 202000827/3

Tiranë ___/___/2020

Lënda: *Rekomandohet marrja e masave për ekzekutimin pa vonesë, brenda një afati të arsyeshëm dhe në përputhje me parashikimet e K.Pr.C. të Vendimit Gjyqësor nr.335, datë 28.02.2019, të dhënë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Durrës.*

Drejtuar: **Përmbaueses Gjyqësore**
Zj. Iva Kujofsa
Pranë: Zyrës së Përmbaimit

DURRËS

Për dijëni: **Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit të Përmbaimit Gjyqësor Shtetëror**
Z.Piro Lutaj

TIRANË

Z. ***

Adresa: Lagja Popullore, Shijak

DURRËS

Të nderuar zonja dhe zotërinj!

Sikurse jeni në dijëni, Institucioni i Avokatit të Popullit, ka në proces shqyrtimi ankesën e shtetasit ***, i cili ankohet ndaj Zyrës së Përmbaimit Durrës, për mosekzekutimin e Vendimit Gjyqësor nr.335, datë 28.02.2019, të dhënë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, për të cilin po kjo Gjykatë ka lëshuar urdhërin e ekzekutimit me Vendimin nr.305, datë 25.04.2019, me objekt:

*“Detyrimin e të paditurit *** të pushojë cënimin e pronësisë që i bën paditësit *** në pronën e tij, e konkretisht në murin e shtëpisë së tij dhe të avllisë të banesës, dhe të mos e përsërisë më në të ardhmen, duke u detyruar i padituri ***, t’i heqë barakën (garazh), me sipërfaqe 50m², ndërtuar pranë banesës së paditësit”.*

Referuar pretendimeve të ankuesit, se Zyra e Përmbaimit Durrës, pa shkak, nuk ka ekzekutuar dhe nuk ekzekuton detyrimin e vendosur, ju jemi drejtuar me shkresën

nr.K3/S26-2 Prot, datë 08.11.2019, për dhënie informacioni dhe shpjegimesh rreth kësaj çështjeje.

Në përgjigje të kërkesës së Avokatit të Popullit, ju me Tuajën nr.155/1 Prot, datë 12.11.2019, bëni të ditur veprimet përmbarimore të kryera për ekzekutimin e detyrueshëm të titullit të mësipërm ekzekutiv.

Ju informoni midis të tjerave, se me shkresën nr.10/558, datë 13.05.2019, keni lajmëruar palën gjyqbjerrëse për detyrimin e vendosur si dhe caktimin e afatit ligjor 10 ditor për ekzekutimin vullnetarisht të tij.

Në kushtet e mospërmbushjes së detyrimit në mënyrë vullnetare, në afatin ligjor të bërë të ditur, ju informoni, se kishit caktuar datën 17.06.2019, ora 10.00, për kryerjen e veprimeve përmbarimore për ekzekutimin e detyrueshëm të titullit ekzekutiv. Në këtë datë dhe orë nuk u krye ekzekutimi i detyrueshëm i titullit ekzekutiv për shkak të mosprezencës së forcave të Policisë së Shtetit dhe përfaqësuesit të Bashkisë Shijak. Më tej, ju informoni, se me shkresën nr.10/558 Prot, datë 08.07.2019, i keni kërkuar Policisë së Shtetit praninë e saj në kryerjen e veprimeve përmbarimore më datë 19.07.2019, ora 10.00, pranë objektit të ekzekutimit. Në këtë datë ju në prani të bashkëshortes së palës gjyqbjerrëse nuk keni kryer ekzekutimin e detyrueshëm të titullit ekzekutiv, duke u justifikuar me paqartësinë e vendndodhjes së objektit që duhet hequr nga sipërfaqja e tokës së palës gjyqfituese. Në vijim, ju shpreheni, se, keni caktuar ekspert për saktësimin e vendndodhjes së objektit që do të prishet.

Qëndrimin e mbajtur nga ana juaj në kryerjen e veprimeve përmbarimore më datë 19.07.2019, nuk e vlerësojmë të rregullt dhe në përputhje me parashikimet e kryera në ligj. Vendndodhja e objektit të ekzekutimit është i mirëpërcaktuar në Akt Ekspertimin datë 13.02.2019, të kryer prej ekspertit ing.***, të thirrur prej Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Durrës, në procesin gjyqësor të zhvilluar. Ky akt ekspertimi është pjesë përbërëse e Vendimit Gjyqësor civil nr.335, datë 28.02.2019, të dhënë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Durrës. Caktimi prej jush i ekspertës ***, në kushtet e lartpërmendura është i pabazuar në ligj dhe shton në mënyrë të padrejtë shpenzimet për ekzekutimin e titullit ekzekutiv. Po kështu, konstatojmë se, ju, tej përcaktimit të kryer në dispozitivin e Vendimit Gjyqësor civil nr.335, datë 28.02.2019, të dhënë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Durrës, shpreheni në shkresën nr.155/1 Prot, datë 12.11.2019, për prishje të objektit, ndërkohë që sipas vendimit gjyqësor në fjalë është vendosur për heqjen e tij nga ana e gjyqbjerrësit, barrakës (garazhdit) me sipërfaqe 50 m² të ndodhur pranë banesës së paditësit.

Me të drejtë nga ana juaj nuk është marrë në konsideratë pretendimi i bashkëshortes të të paditurit, se: *“Objekti që kërkohet të priset është pronë e saj”*, por moskryerja e veprimeve përmbarimore për ekzekutimin e detyrueshëm të titullit të mësipërm ekzekutiv në datë 19.07.2019, vlerësohet i pajustificueshëm. Edhe pse pala gjyqfituese kishte siguruar mjetet dhe fuqi punëtore për realizimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, nuk u mundësua nga ana juaj ekzekutimi në mënyrë të rregullt i titullit ekzekutiv. Kjo situatë është përsëritur edhe më datë 01.10.2019, kur ju keni justifikuar mosekzekutimin e detyrueshëm të titullit ekzekutiv në këtë datë me mungesën e ekspertës së thirrur nga ana juaj. Dhjetë ditë më vonë, më datë 11.10.2019, ju keni shkuar përsëri pranë objektit të ekzekutimit, e mbështetur prej forcave të Policisë së Shtetit, përfaqësuesit të pushtetit vendor, ekspertës së thirrur nga ana juaj. Në këtë datë, ju shpreheni se, bashkëshortja e të paditurit ka kërkuar dhjetë ditë afat për të liruar

barrakën (garazhdin) prej 50 m², nga sendet e ndodhura brenda në të dhe se pala gjyqituese ka pranuar këtë kërkesë. Marrja në konsideratë prej jush e gjendjes së objektit të ekzekutimit, nëse ka apo jo sende brenda tij, është tregues i mosnjohjes së detyrës nga ana juaj, në rastin më të mirë. Në kushtet kur gjykata ka urdhëruar heqjen e barrakës nga sipërfaqja e tokës së paditësit (ankuesit), nga ana juaj nuk mund të merret si shkak për mosekzekutimin e vendimit gjyqësor në fjalë, fakti nëse ajo është plot apo e zbrazur nga sendet prej gjyqbjerrësit. Marrja në konsideratë e kërkesës së bashkëshortes së gjyqbjerrësit për shtyrjen e ekzekutimit të detyrueshëm deri në zbrazjen e barrakës nga sendet e ndodhura në të, në rastin më të mirë e konsiderojmë mosnjohje të detyrës nga ana juaj. Pala gjyqbjerrëse e ka konsumuar afatin ligjor prej 10 ditësh për zbatimin vullnetar të detyrimit, pra dhe të nxjerrjes së sendeve të ndodhura brenda barrakës objekt ekzekutimi, kështu që, ju nuk duhet ta merrnit në konsideratë një kërkesë të tillë. Kjo kërkesë për më tepër kryhej pesë muaj pasi ju kishit nisur ekzekutimin e vendimit. Konstatohet edhe keqpërdorimi i forcave të Policisë, të cilat duhet të vijnë në objekt më shumë se një herë dhe në mënyrë të pajustificueshme.

Në këto kushte, ju keni shtyrë ekzekutimin e titullit ekzekutiv për një datë tjetër. Këtë qëndrim e vlerësojmë jo në përputhje me parashikimin e nenit 615/b të Kodit të Procedurës Civile:

“Ekzekutimi pezullohet:

...

b) me kërkesë të kreditorit;”

Pas kalimit të afatit dhjetë ditor të kërkuar prej bashkëshortes se gjyqbjerrësit, ju shpreheni se, keni kërkuar (urdhëruar) me shkresën nr.10/558 prot, datë 29.10.2019, paraqitjen e saj pranë ambjenteve të Zyrës së Përmbarrimit, Durrës, kërkesë e cila është refuzuar. Kërkesa juaj për paraqitjen e bashkëshortes së gjyqbjerrësit në ambjentet e Zyrës së Përmbarrimit, Durrës, është e pambështetur në ligj. Në asnjë dispozitë të Kodit të Procedurës Civile, apo të ndonjë akti tjetër ligjor apo nënligjor, nuk parashikohet urdhërimi i personit të tretë në procesin e ekzekutimit të titullit ekzekutiv, të paraqitet para përmbarruesit gjyqësor. Ky veprim i kryer prej jush përveçse i pambështetur në ligj, zvarrit në mënyrë të paarsyeshme ekzekutimin e titullit ekzekutiv.

Ndodhur në situatën e prezantuar, ju shpreheni se, me shkresën nr.10/558 prot, datë 05.11.2019, drejtuar Policisë së Shtetit, keni kërkuar mbështetjen për ekzekutimin e vendimit gjyqësor më datë 15.11.2019. Në shkresën nr.02/558 prot, datë 06.12.2019, ju nuk keni dhënë informacion se çfarë veprimi përmbarrimor keni kryer në këtë datë për ekzekutimin e Vendimit Gjyqësor civil nr.335, datë 28.02.2019. Në komunikimin e kryer me ankuesin datë 11.12.2019, vihemi në dijeni, se as në këtë datë nuk keni kryer ekzekutimin e detyrueshëm të vendimit gjyqësor në fjalë dhe as keni caktuar datë tjetër për ekzekutimin e tij.

Nga analiza e kësaj çështjeje, rezulton se, procesi i ekzekutimit të Vendimit Gjyqësor civil nr.335, datë 28.02.2019, të dhënë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Durrës, nuk është kryer brenda një afati të arsyeshëm.

Gjatë kryerjes së veprimeve përmbarrimore nga ana juaj, nuk janë mbajtur parasysh parashikimet e kryera në nenin 606, të Kodit të Procedurës Civile, *“Sanksionet për moskryerjen e veprimit nga debitori”*. Mosrespektimi i detyrimit nga ana e gjyqbjerrësit

në afatin ligjor të përcaktuar, ka përbërë dhe përbën shkak për vendosjen e gjobës ndaj tij. Ushtrimi i kompetencës për vendosjen e sanksionit ndaj gjyqbjerrësit apo personave të tretë mund dhe duhet të ndodh në kushtet e parashikuara në këtë dispozitë ligjore.

Veprimtaria e Zyrës së Përmbarrimit, Durrës, në procesin e ekzekutimit të Vendimit Gjyqësor civil nr.335, datë 28.02.2019, të dhënë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Durrës, në vlerësimin e Institucionit të Avokatit të Popullit, ka cënuar dhe cënon marrëdhëniet juridike të vendosura me ligj për ekzekutimin e titujve ekzekutiv, të cilat sigurojnë jo vetëm veprimtarinë e rregullt të organit që ju përfaqësoni, por dhe mbrojtjen e interesave të ligjshme të shtetasve apo të shtetit, të mbrojtura posaçërisht nga legjislacioni penal kundër veprimeve ose mosveprimeve kriminale.

Në nenin 320/a të Kodit Penal, parashikohet se, vepra penale: *“Mosekzekutimi pa shkaqe të përligjura i vendimit të gjykatës”*, kryhet me mosveprim për mosekzekutimin pa shkaqe të përligjura të vendimit të gjykatës penale ose civile. Shkaqe të përligjura janë ato të sëmundjes së përmbarruesit, vdekje ose fatkeqësie tjetër familjare ose forca madhore. Kur mungojnë këto shkaqe të përligjura, personi i ngarkuar ka përgjegjësi penale për mosekzekutimin e vendimit të gjykatës.

Gjithashtu, nisur nga parashikimi i kryer në nenin 31, dhe 35/dh të ligjit nr.8730, datë 18.01.2001, *“Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit të Përmbarrimit Gjyqësor”*, të ndryshuar, gjykojmë se, qëndrimi i mbajtur prej jush në procesin e ekzekutimit të Vendimit Gjyqësor civil nr.335, datë 28.02.2019, përbën shkak për Drejtorin e Përgjithshëm të Shërbimit të Përmbarrimit Gjyqësor, për inicimin e procedimit disiplinor në ngarkimin tuaj, sikurse parashikuar në nenin 35/dh të këtij ligji.

Ekzekutimi brenda një afati të arsyeshëm i vendimit gjyqësor të formës së prerë konsiderohet si pjesë përbërëse e së drejtës për një proces të rregullt ligjor në kuptim të nenit 42/2 të Kushtetutës si dhe nenit 6/1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Ekzekutimi i tij përbën një element thelbësor të shtetit të së drejtës e të vetë nocionit të gjykimit të drejtë. Asnjë organ shtetëror nuk mund të vërë në diskutim drejtësinë e vendimeve gjyqësore të formës së prerë. Çdo organ shtetëror detyrohet të marrë masat përkatëse për zbatimin e tyre. Gjykata Kushtetuese ka vlerësuar se ekzekutimi i vendimit të formës së prerë të gjykatës konsiderohet si faza përfundimtare e realizimit të një të drejte të fituar gjyqësisht. Vetëm pas realizimit të kësaj faze mund të konsiderohet se individit e ka vendosur plotësisht në vend të drejtën e tij të fituar. Pa dyshim që një vonesë në ekzekutim e një vendimi mund të justifikohet në rrethana të veçanta, por vonesa nuk mund të jetë deri në atë shkallë sa të dëmtojë thelbin e së drejtës.

Gjithashtu, ju bëjmë me dije se, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, në vendimmarrjet e veta, lidhur me të drejtën për të kërkuar ekzekutimin e një vendimi gjyqësor të formës së prerë, ka theksuar se, shteti duhet të marrë përsipër vazhdimisht detyrimin për të siguruar palët pjesëmarrëse në proces se do të kenë mundësi reale të ekzekutojnë vendimin gjyqësor dhe se e drejta për të pasur akses në gjykatë do të ishte iluzion, nëse sistemi ligjor ose zbatimi i tij në praktikë do të bëhej shkak që një vendim gjyqësor i formës së prerë të mbetet joefektiv dhe i pazbatueshëm për një kohë të gjatë. Gjykata Kushtetuese në vendimmarrjet e saj ka pranuar se : *“...parimet kushtetuese lidhur me procesin e rregullt ligjor, për të cilin bën fjalë neni 42/2 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së si dhe detyrimi për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të parashikuara në nenin 142/3 të Kushtetutës, nënvizojnë faktin se çdo qytetar, i cili i*

drejtohet një gjykate kompetente për realizimin e një të drejte, nuk mund të presë pakufi për realizimin e saj”.

Në situatën juridike në të cilën ndodhet çështja, Avokati i Popullit, nisur nga parimi i zbatimit të ligjshmërisë, rritjes së efektivitetit në ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, si dhe për një zgjidhje ligjore të këtij problemi, çmon me vend të rekomandojë kryerjen e veprimeve përmbarimore, të cilat mundësojnë rivendosjen në vend të së drejtës së shkelur ankuesit.

Për arsyet e përmendura, në përputhje me nenin 63/3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në të cilin sanksionohet, se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur konstaton shkelje të të drejtave dhe lirive nga administrata publike”*, si dhe nenin 21/b, të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999 *“Për Avokatin e Popullit”*, të ndryshuar, i cili parashikon, se: *“Avokati i Popullit paraqet rekomandime për marrje masash për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që ka shkaktuar shkeljen”*,

REKOMANDOJMË

Marrjen e masave të menjëhershme për ekzekutimin pa vonesë të Vendimit Gjyqësor nr.335, datë 28.02.2019, të dhënë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Durrës.

Marrjen e masave që veprime të tilla të mos përsëriten në të ardhmen.

Mbështetur në nenin 19, të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999, *“Për Avokatin e Popullit”*, të ndryshuar, kthimi i përgjigjes duhet të bëhet brenda 30 ditëve nga data e dërgimit të kësaj shkrese.

Duke besuar në bashkëpunimin tuaj.

KOMISIONERI

Prof.Asoc.Dr. Erjona BANA(CANAJ)